



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/58
Datë: 14.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, si dhe në nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur me 14.01.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Punës së Qeverisë për periudhën qershor-dhjetor 2020.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/58
Datë: 14.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, si dhe në nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur me datë 14.01.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projekt Rregullore për Rregullat dhe Mënyrën e Sjelljes së Vizitorëve në Hapësirat e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.
2. Obligohet institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/58

Datë: 14.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, si dhe në nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur me 14.01.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projekt Udhëzimi Administrativ për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjesisë Penale.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/58

Datë: 14.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, si dhe në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur me datë 14.01.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projekt Udhëzimi Administrativ për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.05/58

Datë: 14.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, si në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet nisma për lidhjen e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.
2. Autorizohet Ministria e Punëve të Brendshme të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lidhjen e marrëveshjes nga pika 1 e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.06/58

Datë: 14.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 i Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, i ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020 dhe në pajtim me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar me datë 05.06.2020 nr. 01/02, në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen masat për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike për vitin 2021, në vlerë prej dyqind e njëzet e dy milionë e katërqind mijë euro (222,400,000.00 €), me masat dhe shumat si në vijim:

- 1.1. **MASA 1** – Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në nën-programin Ndërmarrësia, do të ndahen 6,500,000 € (gjashtë milionë e pesëqind mijë euro). Ndarja e mjeteve bëhet për vazhdimin e subvencionimit në emër të linjës së pagave për bizneset aktive dhe “Të vetëpunësuarit”, me kriteret që do të caktohen me vendim të veçantë të Qeverisë.
- 1.2. **MASA 2** – Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, do të ndahen mjete në shumë 5,000,000 € (pesë milionë euro) për mbështetjen e sektorit të arsimit për të mundësuar mbarëvajtjen e mësimin gjatë vitit shkollor 2020/21;
- 1.3. **MASA 3** - Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, do të ndahen mjete në shumë 2,500,000 € (dy milionë e pesëqind mijë euro) për mbështetjen financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve tjera jo formale, stimulimin e aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe rivitalizimit të tyre;
- 1.4. **MASA 4** – Në Zyrën e Kryeministrit, nën-programi Agjencia për Barazi Gjinore, do të ndahen mjetet në shumë 1,000,000 € (një milionë euro) për mbështetjen financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi;

1.5. **MASA 5** – Në Ministrinë e Shëndetësisë, për mbështetjen e sektorit të shëndetësisë do të ndahen mjete në shumë 50,000,000 € (pesëdhjetë milionë euro) dhe atë si vijon:

1.5.1. Blerja e vaksinave anti COVID-19 në shumë 40,000,000 € (dyzetë milionë euro) dhe

1.5.2. Blerja e materialeve për menaxhimin e pandemisë COVID-19 dhe aparaturave mjekësore në shumë 10,000,000 € (dhjetë milionë euro).

1.6. **MASA 6** – Sigurimi i shtesës mbi pagë për sektorët që bartin barrën kryesore në menaxhimin e pandemisë, për punëtorët e këtyre sektorëve në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërsëdrejti rrezikut të infektimit me COVID-19 në punën e tyre (jo i gjithë stafi i këtyre institucioneve), do të ndahen mjete në shumë 11,000,000 € (njëmbëdhjetë milionë euro).

1.7. **MASA 7** – Në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në nën-programin Departamenti i Politikave Bujqësore, do të ndahen mjete në shumë 12,000,000 € (dymbëdhjetë milionë euro) sipas kritereve dhe procedurave të Programit për Pagesat Direkte për vitin 2021.

1.8. **MASA 8** – Në Ministrinë Tregtisë dhe Industrisë, në nën-programin Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, do të ndahen mjete në shumë 9,000,000 € (nëntë milionë euro) dhe atë si vijon:

1.8.1. Subvencionimi i eksportit për prodhuesit vendor në shumë 5,000,000 € (pesë milionë euro);

1.8.2. Subvencionimi i stokeve të qumështit dhe produkteve të qumështit në shumë 1,000,000 € (një milionë euro) dhe

1.8.3. Subvencionimi i sektorëve të prekur nga vendimet e Qeverisë për ndalimin e aktiviteteve (gastronomia, sallat e dasmave, sallat e sportit, qendrat rehabilituese dhe të ngjashme), në shumë 3,000,000 € (tre milionë euro).

1.9. **MASA 9** - Mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, në shumë 7,900,000 € (shtatë milionë e nëntëqind mijë euro).

1.10. **MASA 10** – Në Ministrinë e Financave, përkatësisht Thesar, lidhur me rritjen e mbulueshmërisë së kredive të reja dhe lehtësimin e qasjes në financa, do të ndahen mjete në shumë 44,500,000 € (dyzetë e katër milionë e pesëqind mijë euro), për Fondin Kosovar për Garanci të Kredive, dhe atë si vijon:

1.10.1. Rritja e kapitalit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore në shumë 40,000,000 € (dyzetë milionë euro) dhe

1.10.2. Mbulimi i kostos së tarifës së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, në shumë 4,500,000 € (katër milionë e pesëqind mijë euro).

1.11. **MASA 11** - Ndahen mjete në shumë 21,000,000 € (njëzet e një milionë euro) për Ndërmarrjet Publike financuar nga Kredia e Likuiditetit të Urgjencës së Infrastrukturës Vitale financuar nga BERZH, në momentin e pranimit të tyre. Këto mjete kanalizohen përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, nën-programit Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve.

1.12. **MASA 12** - Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në nën-programin Mjedisi, do të ndahen mjete në shumë 3,000,000 € (tre milionë euro) për realizimin e projektit "Për ambientin dhe gjelbërimin e tokës" me kod 18745.

1.13. **MASA 13** - Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në nën-programin Ndërmarrësia, për mbështetje për ndërmarrësi, do të ndahen mjete në shumë 1,000,000 € (një milionë euro).

1.14. **MASA 14** - Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në nën-programin Ndërmarrësia do të ndahen mjete në shumë 16,000,000 € (gjashtëmbëdhjetë milionë euro), për subvencionim për tarifën e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (BRE), në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19.

1.15. **MASA 15** - Në Ministrinë e Zhvillimi Rajonal, në nën-programin Administrata Qendrore do të ndahen shuma 1,000,000 € (një milion euro) për mbështetjen e programeve ekzistuese dhe të reja që lidhen me zhvillimin rajonal që ndikojnë në zhvillimin e balancuar rajonal.

1.16. **MASA 16** - Në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në nën-programin Ndhimat Sociale me kod 00500, do të ndahen mjete në shumë 31,000,000 € dhe atë si vijon:

1.16.1. Mbështetje për skemat pensionale për individët që përfitojnë më pak se 100 euro në muaj në shumë 13,500,000 € (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë euro)

1.16.2. Mbështetje për skemat sociale në shumë 7,500,000 € (shtatë milionë e pesëqind mijë euro) dhe

1.16.3. Mbështetje për personat që kanë humbur vendet e punës, si pasojë e pandemisë (COVID-19) në shumë 10,000,000 € (dhjetë milionë euro).

2. Mjetet sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndahen dhe alokohen me vendim të veçantë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të propozimeve dhe planeve të ministrive të linjës, sipas prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, disponueshmërisë së mjeteve dhe burimeve të financimit, në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, sipas nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

3. Alokimi i mjeteve të ndara sipas pikës 2 të këtij vendimi bëhet në mënyrë graduale te ministrinë e linjës të ngarkuar për zbatim të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, në përputhje me rrjedhën e parasë, rregullat fiskale, dhe dinamikën e zbatimit të masave të përcaktuara në këtë vendim.

4. Me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, obligohen të gjitha ministrinë përgjegjëse për zbatimin e masave sipas këtij vendimi, të përgatisin planet dhe kriteret sektoriale për zbatimin e masave, që

miratohen në Qeveri, me të cilat kërkohet ndarja buxhetore sipas pikës 2 të këtij vendimi. Me këtë rast, ministria propozuese duhet të definojë nën-programin buxhetor, kategorinë e shpenzimeve dhe burimin e financimit ku duhet të ndahen dhe alokohen mjetet për shpenzim.

5. Planet dhe kriteret sektoriale për zbatimin e masave specifike, sipas nevojës, përgatiten në koordinim me Zyrën e Kryeministrit, në konsultim me sektorin privat (shoqatat, odat, etj), shoqërinë civile, dhe koordinohen me donatorët e përfshirë në ministritë përkatëse për të siguruar sinergjinë e nevojshme ndërmjet fondeve të qeverisë së Kosovës dhe atyre të donatorëve.

6. Mjetet që ndahen në zbatim të këtij vendimi, përdoren ekskluzivisht për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë vendim dhe Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike për vitin 2021.

7. Në rast se shuma e mjeteve të aprovuara për zbatimin e masave sipas pikës 2 të këtij vendimi rezulton në tepriçë, mjetet ri-destinohen me vendim të Qeverisë për financimin e masave tjera brenda Programit të Rimëkëmbjes ekonomike apo të këtij vendimi.

8. Obligohen të gjitha ministritë përgjegjëse për implementimin e masave të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, për zbatimin e këtij vendimi.

9. Obligohet Ministria e Financave që pas pranimit të kërkesave nga ministritë përgjegjëse për zbatim të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, të procedojë në Qeverinë e Republikës së Kosovës propozim vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore, në pajtim me pikën 2 të këtij vendimi.

10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.07/58
Datë: 14.01.2021


Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me ndryshimet dhe plotësimet e tij, Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2021, merr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet alokimi i parakohshëm nga ndarjet aktuale buxhetore të organizatës buxhetore Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me kod 247, në nën-programin Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me kod 25700, për të gjitha kategoritë e shpenzimeve me qëllim të mbarëvajtjes së zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së datës 8 janar 2021 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.
2. Aprovohet kërkesa e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me kod 247, për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 45,269.68 € (dyzetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë nëntë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent), në nën programin Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me kod 25700 në këto kategori të shpenzimeve:
 - 2.1. Në kategorinë shpenzimeve "Paga dhe Shtesa" shuma prej 13,669.68 € (trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent);
 - 2.2. Në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" shuma prej 31,600.00 € (tridhjetë e një mijë e gjashtëqind euro).

3. Mjetet nga pika 2 e këtij vendimi, merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës.
4. Në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, orët e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për punonjësit e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, kalkuloohen dhe paguhen sipas legjislacionit në fuqi.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.08/58
Datë: 14.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës me ndryshimet dhe plotësimet e tij, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, si dhe në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Shëndetësisë për përjashtimin e nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e tij për negocimin e kontratës për vaksina COVID - 19.
2. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë për negocimin e kontratës për vaksina COVID - 19 për furnizim.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.09/58

Datë: 14.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 55, nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, në zbatim të nenit 5, paragrafi 2.4, nenin 10, dhe nenin 12, të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11, datë 15.03.2020, për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, në zbatim të rekomandimeve të IKSHPK-së, me qëllim të kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19, në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtëse nga pandemia Covid-19

I. MASAT PËR TËRË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Hyrjet e qytetarëve të huaj dhe vendorë në Kosovë

1. Qytetarët e huaj që hyjnë në Kosovë, përfshirë edhe ata me leje qëndrim të përkohshëm ose përhershëm në Kosovë, që vijnë nga vendet me risk të lartë sipas listës zyrtare të ECDC-së, duhet të kenë test RT-PCR negativ për Covid-19 të bërë në 72 orët e fundit, në bazë të parimit të reciprocitetit.
2. Përfshirë nga pika 1 më lartë bëjnë:
 - 2.1. Nëse qytetari i huaj hynë në Kosovë përmes aeroportit apo përmes pikave kufitare tokësore dhe largohet nga Kosova brenda 3 ore përmes aeroportit ose pikave kufitare tokësore, me kusht që në hyrje të nënshkruajnë deklaratën se do ta lëshojë Kosovën brenda 3 ore;

- 2.2. Qytetarët e huaj që punojnë si transportuesi profesionistë (vozitësit), me kusht që të respektojnë protokollin për transport ndërkombëtarë për mbrojtje nga Covid-19;
- 2.3. Qytetarët e huaj që kalojnë nëpër Kosovë përmes transportit të organizuar me autobus ose me linjë të rregullt ndërkombëtare tranzite, me kusht që të nënshkruhet deklarata se do ta lëshojnë territorin e Kosovës brenda 5 orësh;
- 2.4. Diplomatët e huaj të akredituar në Kosovë si dhe familjarët e tyre;
3. Të gjithë qytetarët e Kosovës (përfshirë edhe ata me vendbanim në një shtet tjetër), gjatë hyrjes në Kosovë duhet të paraqesin vërtetim për test RT-PCR negativ të bërë më së largu 72 orë para hyrjes në Kosovë, në të kundërtën duhet të vetë-izolohen për 7 ditë.
4. Përjashtim nga pika 3 më lartë bëjnë qytetarët e Kosovës (përfshirë edhe ata me vendbanim në një shtet tjetër) që kanë dalë jashtë Kosovës në 24 orët e fundit.

Organizimi i punës së institucioneve publike dhe organizatave/bizneseve private

5. Institucionet publike dhe organizatat/bizneset private pa përjashtim obligohen të mbikëqyrin në baza ditore shëndetin e stafit në përputhje me "Manualin për mbrojtje nga përhapja e Covid-19", përfshirë matjen e detyrueshme të temperaturës për të gjithë gjatë hyrjes në objekte.
6. Për aq sa nuk ndikon në kryerjen e shërbimeve dhe detyrave të institucioneve, institucionet publike udhëzohen të punojnë vetëm me staf esencial.
7. Punëtorët me sëmundje kronike (sipas qarkores zyrtare të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë e përgatitur për këtë qëllim), gratë shtatzëna dhe gratë gjdhënëse lirohen nga paraqitja në punë, si në institucionet publike ashtu edhe në ato private, ndërkaq punëdhënësit udhëzohen, për aq sa është e mundur, të krijojnë kushtet për angazhimin e tyre në punë nga shtëpia.
8. Obligohen institucionet publike dhe private të mbajnë dezinfektues për duar dhe maska për fytyrë në vende të qasshme në hyrje të objektit, të cilat mund të shfrytëzohen nga punëtorët e institucioneve dhe vizitorët.
9. Obligohen institucionet publike dhe private që në hyrje të çdo objekti të vendosin shenja të dukshme të rregullave të sjelljes për mbrojtje nga Covid-19 (përfshirë shenjën e ndalimit të hyrjes në objekt pa maska, respektim e distancës etj.) në përputhje me "Manualin për mbrojtje nga përhapja e Covid-19".
10. Obligohen përgjegjësit e institucioneve publike, ndërmarrjeve private dhe të çfarëdo subjekti tjetër, të ndërmarrin masa të rrepta për parandalimin e përhapjes së infeksionit brenda institucioneve të tyre, duke bërë dezinfektim të vazhdueshëm dhe duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në përputhje me "Manualin për mbrojtje nga përhapja e Covid-19".
11. Të gjitha institucioneve publike (qendrore dhe lokale) si dhe organizatave, bizneseve dhe subjekteve private pa asnjë përjashtim, iu ndalohet organizimi i çfarëdo ceremonie festive.

Organizimi i procesit arsimor

12. Procesi arsimor në institucionet parauniversitare, publike dhe private, për gjysmë-vjetorin e dytë fillon më datë 18 janar 2021 dhe organizohet sipas planit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
13. Procesi arsimor në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, publik dhe privat, organizohet sipas plan-programit të institucioneve përkatëse në formën online, përveç provimeve, punës praktike dhe laboratorike që duhet të organizohet në përputhje me rekomandimet e IKShPK-së dhe MSh-së.
14. Veprimtaria e çerdheve publike dhe private vazhdon sipas vlerësimit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet komunale, bazuar në "Manualin për mbrojtje nga përhapja e Covid-19", përfshirë matjen e temperaturës së fëmijëve dhe stafit në baza ditore gjatë hyrjes në objekte.
15. Konviktet dhe menzat punojnë duke respektuar manualin për mbrojtje dhe përhapjen nga Covid-19.
16. Të gjitha institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit, publik dhe privat, iu ndalohe organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore, siç janë ekskursionet, shëtitjet grupore, ahengjet e ndryshme të stafit mësimor dhe nxënësve-studentëve dhe të ngjashme.

Organizimi i shtabeve emergjente komunale dhe shërbimeve shëndetësore komunale

17. Komunave iu kërkohet të mbajnë të aktivizuar plotësisht shtabet emergjente komunale për të mbikëqyrë zbatimin e masave, gjendjen shëndetësore të qytetarëve të infektuar me Covid-19 dhe çështje të tjera, si dhe të koordinohen me nivelin qendror përkatës.
18. Shtabeve emergjente komunale, drejtorive për shëndetësi dhe QKMF-ve iu kërkohet të mbikëqyrin dhe ofrojnë shërbimet e nevojshme shëndetësore për së paku 2 javë për personat e infektuar me Covid-19 dhe do të raportojnë në baza ditore në QRSHP-IKSHPK.
19. Komunave iu kërkohet të ofrojnë shërbimet shëndetësore shtëpiake për të gjithë sëmurët kronikë dhe për personat mbi moshën 65 vjeç.
20. Komunave iu kërkohet që, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, të ofrojnë ekipet mjekësore teknike për të bërë kontrollin rutinor të qytetarëve të huaj dhe vendorë që hyjnë në territorin e Kosovës siç specifikohet në pikën 4 më lartë në këtë vendim.

Masat për personat mbi moshën 65 vjeç

21. Personave mbi moshën 65 vjeç iu lejohe dalja jashtë shtëpisë vetëm gjatë orarit 6:00-10:00 dhe 16:00-19:00, ndërkaq jashtë këtij orari mund të dalin vetëm për nevoja emergjente dhe shëndetësore duke e dëshmuar me dokument përkatës nevojën për dalje jashtë këtij orari tek organi kompetent kontrollues.

22. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në përputhje me situatën e krijuar dhe sipas rekomandimeve të IKSHPK-së dhe MSH-së, udhëzohet të lirojë të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që menaxhohen nga MPMS-ja nga paraqitja e rregullt në zyrrat përkatëse për qëllime të evidentimit siç kërkohet me ligjet përkatëse.
23. Qytetarëve që qëndrojnë në shtëpitë për të moshuar u ofrohen të gjitha shërbimet shëndetësore, sociale dhe kontrolla të rregullta shëndetësore nga QKMF-të.

Masat për aktivitetet publike

24. Në hapësira të mbyllura ndalohet grumbullimi i qytetarëve në numër prej më shumë se 30 personave, ndërsa në sheshe publike, parqe, vende publike, qendra rekreative dimërore dhe të ngjashme, lejohet grumbullimi deri në 50 persona me përjashtim rasteve të lejuara me këtë vendim.
25. Të gjitha tubimet publike të organizuara në hapësira publike të të gjitha formave, ndalohen në jo më shumë se 50 persona, me përjashtim të rasteve të lejuara me këtë vendim.
26. Seminaret dhe punëtoritë e të gjitha institucioneve publike dhe private, lejohen të organizohen sipas manualit për mbrojtjen nga përhapja e COVID19 dhe konform pikës 24 të këtij vendimi.
27. Ndalohet organizimi i dasmave dhe ahengeve familjare.
28. Ndalohen ceremonitë dhe veprimtaritë fetare, përveç me pjesëmarrjen e familjes së ngushtë.
29. Përjashtim nga pika 28 më lartë bëjnë ceremonitë e veçanta fetare që organizohet me leje të veçantë të Ministrisë së Shëndetësisë bazuar në rekomandimet e IKSHP-së.

Masat për aktivitetet biznesore

30. Lejohet veprimtaria e tregjeve publike të automjeteve dhe kafshëve deri në 40% të sipërfaqes së kapaciteteve të hapësirave.
31. Therja e kafshëve lejohet vetëm në ambientet e autorizuara për këtë qëllim.
32. Lejohet ushtrimi vetëm i veprimtarive si në vijim (sipas kodeve NACE të përcaktuara nga ARBK - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë):
 - 32.1. Sektori shëndetësisë,
 - 32.2. Sektori i sigurisë dhe drejtësisë,
 - 32.3. Sektori publik (administratë qendrore dhe komunale),
 - 32.4. Sektori i prodhimit,
 - 32.5. Sektori i bujqësisë dhe blegtorisë,
 - 32.6. Sektori i ndërtimit,
 - 32.7. Transporti i mallrave,
 - 32.8. Sektori i produkteve ushqimore,

32.9. Sektori i shërbimit/distribuímit.

II. MASAT SPECIFIKE SIPAS KOMUNAVE

33. Komunat kategorizohen në tri grupe sipas bazuar në rrezikun nga përhapja e infeksionit:

- 33.1. Komunat me rrezik të ultë - deri në 75 persona të infektuar për 100,000 banorë brenda një jave (me ngjyrë të gjelbër),
- 33.2. Komunat me rrezik të mesëm - nga 76-150 persona të infektuar për 100,000 banorë brenda një jave (me ngjyrë të verdhë),
- 33.3. Komunat me rrezik të lartë - mbi 150 persona të infektuar për 100,000 banorë brenda një jave (me ngjyrë të kuqe).

34. Në baza javore, çdo të premtë, IKSHP-ja dhe MSF-ja publikojnë shifrat e të infektuarve sipas komunave dhe bëjnë kategorizimin e komunave sipas nivelit të rrezikut të përshkruar në pikën më lartë.

35. Masat për komunat me rrezik të ulët (deri në 75 persona të infektuar për 100,000 banorë brenda javës):

- 35.1. Operatorët ekonomik lejohen të punojnë nga 05:00-22:00,
- 35.2. Qendrat tregtare lejohen të punojnë nga 05:00-22:00,
- 35.3. Shërbimet e hotelerisë dhe gastronomisë lejohen të punojnë nga 05:00-22:00, ndërkaq pas orës 22:00 punojnë me shërbim "merr me vete" dhe "porosi me dërgesë",
- 35.4. Transporti publik lejohet të punoj duke shfrytëzuar deri në 50% të kapaciteteve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 35.5. Taksitë lejohen të punojnë me një (1) pasagjer prapa ose deri në tre (3) nëse janë anëtarë të familjes, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 35.6. Institucioneve vartëse të MKRS dhe komunave (siç janë teatrot, bibliotekat, filarmonia, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe dhe të ngjashme), lejohet të punojnë deri në orën 22:00 duke shfrytëzuar deri në 40% të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse për të gjitha aktivitetet (si në shfaqje ashtu edhe në ushtrime), duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 35.7. Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura, ku gjatë stërvitjeve në hapësirat e mbyllura mund të marrin pjesë deri në 20 persona, ndërsa gjatë garave deri në 50 persona, gjithmonë bazuar në protokolle vendore dhe ndërkombëtare sportive, si dhe duke u bazuar në "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 35.8. Lejohen fitneset dhe pishinat e mbyllura për aktivitete individuale rekreative duke shfrytëzuar deri në 40% të hapësirave/sipërfaqeve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 35.9. Pavarësisht pikave 35.6, 35.7 dhe 35.8 më lartë, autorizohet Ministria e Shëndetësisë që bazuar në rekomandimet e IKSHP-së të nxjerrë vendime operacionale të ndalojë këto aktivitete.

36. Masat për komunat me rrezik të mesëm (prej 76-150 persona të infektuar për 100,000 banorë brenda javës):

- 36.1. Operatoret ekonomik lejohen të punojnë nga 05:00-22:00.
- 36.2. Qendrat tregtare lejohen të punojnë nga 05:00-22:00.
- 36.3. Shërbimet e hotelerisë dhe gastronomisë lejohen të punojnë nga ora 05:00 deri në ora 22:00, ndërkaq pas orës 22:00 punojnë me shërbim "merr me vete" dhe "porosi me dërgesë".
- 36.4. Të gjitha institucionet publike dhe private këshillohet të reduktojnë stafin bazuar në specifikat e tyre dhe "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
- 36.5. Transporti publik lejohet të punojë duke shfrytëzuar deri në 50% të kapaciteteve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
- 36.6. Taksitë lejohen të punojnë me një (1) pasagjer prapa ose tre (3) nëse janë anëtarë të familjes, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
- 36.7. Institucioneve vartëse të MKRS dhe komunave (siç janë teatrot, bibliotekat, filarmonia, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe dhe të ngjashme), lejohet të punojnë vetëm deri në orën 22:00 duke shfrytëzuar deri në 40% të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse për të gjitha aktivitetet (si në shfaqje ashtu edhe në ushtrime), duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 36.8. Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura, ku gjatë stërvitjeve në hapësirat e mbyllura mund të marrin pjesë deri në 20 persona, ndërsa gjatë garave deri në 50 persona, gjithmonë bazuar në protokolle vendore dhe ndërkombëtare sportive, si dhe duke u bazuar në "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 36.9. Lejohen fitneset dhe pishinat e mbyllura për aktivitete individuale rekreative duke shfrytëzuar deri në 40% të hapësirave/sipërfaqeve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19".
- 36.10. Pavarësisht pikave 36.7, 36.8 dhe 36.9 më lartë, autorizohet Ministria e Shëndetësisë që bazuar në rekomandimet e IKSHP-së të nxjerrë vendime operationale të ndalojë këto aktivitete.

37. Masat për komunat me rrezik të lartë (mbi 150 persona të infektuar për 100,000 banorë brenda javës):

- 37.1. Ndalohet lëvizja e qytetarëve jashtë shtëpive/banesave të tyre nga ora 21:30 deri në orën 05:00, përveç për nevoja emergjente dhe shëndetësore të dokumentuar në mënyrë të përshtatshme, duke përjashtuar nga kjo masë personelin shëndetësorë, të sigurisë, të drejtësisë dhe të ngjashme;
- 37.2. Ndalohen hyrje-daljet e qytetarëve dhe automjeteve në territorin e komunës përkatëse nga ora 21:30 deri në orën 05:00, përveç:
 - 37.2.1. Personelit shëndetësor, të sigurisë, drejtësisë dhe të ngjashme,
 - 37.2.2. Qytetarëve për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim, dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim, barna për njerëz dhe kafshë e shpezë),
 - 37.2.3. Operatorëve ekonomik dhe transportit të mallrave/shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit,
 - 37.2.4. Kompanive ndërtimore,
 - 37.2.5. Operatorëve që kryejnë punë publike.

- 37.3. Operatoret ekonomik lejohen të punojnë nga 05:00-21:00.
- 37.4. Qendrat tregtare lejohen të punojnë nga 05:00-21:00.
- 37.5. Shërbimet e hotelerisë dhe gastronomisë lejohen të punojnë nga 05:00-21:00, ndërkaq pas orës 21:00 punojnë vetëm me shërbim "porosi me dërgesë".
- 37.6. Institucionet publike dhe private obligohen të punojnë vetëm me staf esencial, i cili staf përcaktohet me vendim të secilit institucion në veçanti;
- 37.7. Transporti publik lejohet të punojë duke shfrytëzuar deri në 50% të kapaciteteve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
- 37.8. Taksitë lejohen të punojnë me një (1) pasagjer prapa ose tre (3) nëse janë anëtarë të familjes, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
- 37.9. Institucioneve vartëse të MKRS dhe komunave (siç janë teatrot, bibliotekat, filarmonia, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe dhe të ngjashme), lejohet të punojnë vetëm deri në orën 21:00 duke shfrytëzuar deri në 40% të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse për të gjitha aktivitetet (si në shfaqje ashtu edhe në ushtrime), duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 37.10. Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura, ku gjatë stërvitjeve në hapësirat e mbyllura mund të marrin pjesë deri në 20 persona, ndërsa gjatë garave deri në 50 persona, gjithmonë bazuar në protokolle vendore dhe ndërkombëtare sportive, si dhe duke u bazuar në "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19",
- 37.11. Lejohen fitneset dhe pishinat e mbyllura për aktivitete individuale rekreative duke shfrytëzuar deri në 40% të hapësirave/sipërfaqeve, duke respektuar "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19".
- 37.12. Pavarësisht pikave 37.9, 37.10 dhe 37.11 më lartë, autorizohet Ministria e Shëndetësisë që bazuar në rekomandimet e IKSHP-së të nxjerrë vendime operacionale të ndalojë këto aktivitete.

III. OBLIGIMET E INSTITUCIONEVE PËR ZBATIMIN E MASAVE

- 38. Obligohet Ministri i Shëndetësisë që në rast nevojë të nxjerrë udhëzime për sqarimin e pikave të këtij vendimi.
- 39. Obligohet Ministri i Shëndetësisë, AUVK dhe Policia e Kosovës, që në bashkëpunim me shtabet emergjente komunave, të mbikëqyrë zbatimin e këtij vendimi dhe të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raport javor (çdo të premte deri në orën 16:00).
- 40. Obligohet Ministri i Shëndetësisë, SHSKUK dhe IKSHP të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raportin javor (çdo të premte deri në orën 16:00) për zbatimin e masave, gjendjen në institucionet shëndetësore, gjendjen epidemiologjike si dhe parashikimet për dy javët në vijim.
- 41. Obligohet Ministri i Shëndetësisë që, bazuar në Ligjin nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e pandemisë Covid-19, të nxjerrë vendime operacionale varësisht prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKSHP-së.

42. Obligohet Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse të mbikëqyrin zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera në zbatimin e Ligjit Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës.
43. Për shkelësit e masave, organet kompetente obligohen të shqiptojnë masat ndëshkimore sipas Ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe ligjeve të tjera në fuqi.
44. I vetmi autoritet që mund të interpretojë këtë vendim është Ministria e Shëndetësisë, ndërkaq çdo institucion tjetër mund të ofrojë sqarime për grupet respektive që preken nga ky vendim vetëm pas miratimit të atij sqarimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
45. Ministria e Shëndetësisë obligohet të publikojë në faqen zyrtare të saj Qarkoren lidhur me sëmundjet kronike, për të cilat sëmundje personat sipas pikës 8 të këtij vendimi lirohen nga paraqitja në punë.
46. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe vlen deri në një vendim tjetër.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjitha ministrive (ministrave);
- Komunave;
- Inspektorateve përgjegjëse;
- Policisë së Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM - së;
- Arkivit të Qeverisë.